



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 33, 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe Rregullores Nr 07/2016 për suvencionimin e projekteve filmike të QKK-së shpall:

KONKURS PËR FILM TË METRAZHIT TË GJATË - TË REGJISORËVE DEBUTANT Ref. Nr. QKK-03/2018

Për Subvencionim të projekteve kinematografike të filmit të gjatë – të regjisorëve debutant, për vitin 2018.

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë personat juridik, vendës ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

I. Aplikimi bëhet online në linkun www.qkk-rks.com , ku ndër të tjera në aplikim kërkohen:

1. Testi i kulturës
2. Buxheti
3. Sinopsisi në gjuhën zyrtare dhe angleze
4. Skenari në gjuhën zyrtare dhe angleze
5. Koncepti Regjisorial
6. CV të autorëve kryesorë
7. Pagesa aplikimit 100.00€ (njëqind euro)

II. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. **Shtëpitë filmike dhe producentët** që janë me vonesë në zbatimin e kontratës me QKK-në për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurimi me më shumë se dy projekte brenda vitit, projektet duhet të jenë të kategorive të ndryshme.
3. Një producent ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
4. Një regjisor ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
5. I njejt person nuk mund të jetë regjisor dhe producent i të njejtit projekt.

6. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
7. Personat që aplikojnë në cilësinë e regjisorit në një projekt, nuk kanë të drejtë të aplikojnë në cilësinë e producentit në një projekt tjetër dhe anasjelltas.
8. Filmat televiziv të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrje/aplikimi.
9. Buxheti i filmit nuk mund të jetë më i lartë se 70 mijë euro.
10. QKK mund të mbështet deri në 60 mijë euro.
11. Projektet që janë refuzuar dy herë nuk kanë të drejtë aplikimi.
12. Si dhe kriteret tjera të parapara me rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike të QKK-së.

Data e fundit për aplikim është: **04. Maj. 2018**

Pagesa e aplikimit duhet të bëhet për:

Qendra Kinematografike e Kosovës

BPB – Banka për Biznes

Nr. i xhironlogarisë: **1300 0010 0144 0310**